



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRAN	
01 Nr. / Br	62 / 21
Nr. i fq. / Br. st	- 3 -
Data / Datum	25. 03. 2021
VUSHTRRI - VUÇITRAN	



REPUBLIKA E KOSOVË

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

PROCESVERBAL

**NGA MBLEDHJA SOLEMNE E KUVENDIT TË KOMUNËS SË VUSHTRRIË,
MBAJTUR MË 05 MARS 2021 PËR NDER TË EPOPEË SË UÇK-SË**

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë duke filluar në orën 10:10.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë: Abdullah Vojvoda, Bahrije Ademi Murati, Ermal Lahu, Fakete Dushi, Faton Shabani, Fitim Halili, Gresa Muli, Ilmi Azemi, Ilir Krasniqi, Ismet Hajrizi, Hajriz Mustafa, Lorik Maxhuni, Nasuf Aliu, Nezir Klinaku, Nurtene Çerkezi-Gyshinca, Sajdie Bajgora, Selim Rrustemi, dhe Teuta Aruçi Shartari.

Munguan: Agim Bregaj, Ali Januzi, Arta Ymeri, Basri Menxhiqi, Fatmire Saraçi, Gentiana Rama, Habibe Gërzhaliu, Kushtrim Hyseni, Mehdi Bejtullahu, Mejreme Ismajli, Melihate Basholli-Latifi, Miljan Bojković, Suzana Syla, Shkëlzen Feka, Shpëtim Zhegrova dhe Ymer Haradinaj.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe kryetari i komunës z.Xhafer Tahiri, drejtorët e drejtorive komunale, përfaqësuesit e shoqatave të dala nga lufta e UÇK-së përfaqësuesit e KFOR-it dhe zyrtar tjerë kompetent komunal.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Nasuf Aliu – kryesues i kuvendit, i cili konstatoi se në sallë janë të pranishëm 18 anëtarë të kuvendit.

z.Xhafer Tahiri, kryetar i komunës- Të nderuara familje të dëshmorëve të lirisë,
Të nderuar veteran të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës,
Të nderuar veprimtarë të lëvizjes për liri e pavarësi të Kosovës,
Të nderuar përfaqësues të shoqatave të dala nga lufta e UÇK-së
Të nderuar anëtarë të Kuvendit të Komunës,
I nderuar kryesues i Kuvendit të Komunës z. Nasuf Aliu,
Të dashur qytetarë të Vushtrrisë,
Zonja dhe zotërinj,

Epopeja e UÇK-së është ngjarja më heroike që shënojmë si popull, krahas ditës së lirisë e ditës së pavarësisë. Sot, në këtë mbledhje solemne të Kuvendit të Komunës kujtojmë e nderojmë Komandantin Legjendar të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës Adem Jashari dhe sakrificën e madhe të familjes Jashari për liri dhe pavarësi.

Organizimi i një populli në luftë për liri e pavarësi është arritje e shkallës më të lartë të emancipimit të atij populli. Ruajtja e lirisë dhe forcimi i pavarësisë së Kosovës është sfida e përditshme e secilit qytetarë të Republikës së Kosovës. Për të arritur këtë liri e pavarësi të Kosovës që e gëzojmë sot, ranë në altarin e lirisë shumë dëshmorë e martirë, u dhanë gjymtyrë të trupit nga invalidët e UÇK-së dhe u derdhë dije, djersë e mund nga elita intelektuale e kohës në lëvizjen për liri e pavarësi.

Me 5, 6 dhe 7 Mars 1998, në Prekaz të Drenicës u zhvillua një nga betejat më të lavdishme në historinë e të gjithë popujve të botës për liri. Kjo betejë e pabarabartë udhëhiqej nga Ademi, Hamza, Shabani dhe u ndihmua nga secili anëtar i familjes Jashari deri në flijimin e tyre. Në këtë betejë u vranë 53 anëtar të familjes Jashari, prej tyre 21 anëtar të familjes së Adem Jasharit e nga ta 10 ishin fëmijë. Kjo ishte një betejë e pabarabartë në çdo aspekt të saj: ishte e pabarabartë për nga fuqia ushtarake që përdorej në këtë betejë, por po ashtu ishte e pakrahasueshme për nga qëllimi që synohej të arrihej: në njërën anë një familje luftonte për të mbrojtur pragun e shtëpisë, për të rimëkëmbur dinjitetin njerëzor të një populli të tërë e në anën tjetër një ushtri e polici synonte të mbante të robëruar një familje, një popull.

Tregimi për heroizmin e familjes Jashari, Komandantit Legjendar të UÇK-së Adem Jashari, është rrëfimi më emocionues e më inspirues për gjenerata që do të vijnë. Derisa dielli të lind në lindje e të perëndojë në perëndim, Familja Jashari e heroizmi i tyre do të kujtohen e respektohen nga çdo gjeneratë, nga çdo popull lirisdashës kudo në botë.

Prandaj Adem Jashari e Ibrahim Rugova nuk mund të quhen kontradiktor sepse që të dy kishin një qëllim, lirinë e popullit të Kosovës.

Të dashur qytetarë të Vushtrrisë,

Sot kur shumë të rinj ndjejnë dëshpërim, mllëf e pakënaqësi, kur nuk shohin mundësi të barabartë në atdheun e tyre e mësyjnë botën, jam i lumtur që Kosova dhe populli i saj treguan kulturë të lartë shtet formuese duke përdorur votën për ndryshim dhe jo dhunën si mjet për qëllime politike.

Për secilin nga ne në këtë sallë që kemi përgjegjësi publike, për mua si Kryetar i zgjedhur me votë, sfida jonë më e madhe është ta bëjmë Kosovën e Vushtrrinë ashtu siç e ëndërruan dëshmorët e lirisë, ashtu siç e duan të rinjtë dhe të rejtat e këtij vendi të bekuar.


Lavdi dëshmorëve të rënë për liri, lavdi martirëve të lirisë, respekt për veteranët dhe invalidët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Faleminderit, Zoti ju ruajt, Zoti e bekoftë Vushtrrinë, Kosovën dhe popullin e saj!

Gëzim Zuçaku, kryetar i SHFD-së dega në Vushtrri-në adresimin e tij para anëtarëve të kuvendit pasi përshëndeti gjithë të pranishmit, tha se sot, me krenari kujtojmë ditët e Epopesë së UÇK-së: 5, 6 dhe 7 marsin e 1998 – ë. Me krenari kujtojmë luftën e Komandantit legjendar të Adem Jasharit. Me krenari kujtojmë sakrificën e madhe të Jasharëve legjendarë. Nuk ka përkufizim gjuhësor, historik dhe filozofik që kap përmasat e kësaj sakrifice. Kjo Epope mori

përmasat e ngjarjeve të krijimit të botës së re. Të ndërrimit të epokës së robërisë nga epoka e lirisë. Në ditët e Epopesë së UÇK-së u sprovuan vlerat më të larta të kombit: trimëria, besnikëria dhe shpirti heroik. Përmasa e flijimit historik mori dimensione legjendare. Ato ditë heroike nuk u bënë gërmadha kullat e Jasharëve. Në të vërtetë, gërmadhë u bë sundimi serb në Kosovës. Gurët e kullave të Jasharëve u bënë gurë të piramidave kufitare të shtetit të Kosovës. Prandaj kjo sakrificë legjendare për liri u bë model unikat në historinë kombëtare dhe botërore. Njerëzit shpirtmëdhën jo vetëm prekën historinë, por i dhanë trajtë asaj. Dhe çmimi ishte i lartë. Por, faqja e historisë u bë shumë e ndritshme. Me luftën dhe rënien e tyre UÇK-ja u rrit në përmasa gjithëkombëtare, diplomacia botërore u vu në anën e luftës së drejtë të shqiptarëve. Me të drejtë, në analet e historisë moderne botërore, Ushtria Çlirimtare e Kosovës vlerësohet si projekti më i suksesshëm politiko-ushtarak. Vizioni politik i UÇK-së krijoi parakushtet për intervenimin e Aleancës më të fuqishme ushtarake në interes të vendit tonë. Lavdi Komandantit legjendar Adem Jashari, lavdi gjithë Dëshmorëve të kombit nder dhe respekt për gjithë invalidët dhe veteranet e UÇK-së, urime Epoja e UÇK-së Zoti e Bekoftë Republikën e Kosovës dhe popullin e saj.

Mbledhja përfundoi në ora 10:20.

Bastri Duraku

Procesmbajtës

Nasuf Aliu

Kryesues i Kuvendit

